



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Sesioni V

Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim
Mbledhja nr. 22

Prishtinë, 13.10.2015. në orën 13:00.

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Jasmina Živković, Agim Çeku, Mufera Sinik, Agim Kikaj, Milka Vuletić, Saša Milosavljević, Slavko Simić, Qerim Bajrami, Veton Berisha dhe Danush Ademi .

Munguan: Fisnik Ismaili dhe Rustem Berisha.

Pjesëmarrës të tjerë: Ardiana Gashi dhe Senad Karaahmetović përfaqësues të OSBE-së , gazetare e programit në gjuhën serbe të RTK-së Melina Muric, gazetare e RTK-së Albana Bajrami, gazetar nga Kosova Pres- Ismail Shabani, përfaqësues i KAAD Artan Murati, përfaqësues i Sekretariatit të KVZ - Zijush Ahmeti- dhe përfaqësues për media i Kuvendit të Republikës së Kosovës- Celal Iliaz.

Emrat e stafit mbështetës të komisionit: Koordinator - Natasa Prica-Tishma, zyrtare e lartë ligjore - Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: Jasmina Živković, kryetare e Komisionit.

Në mbledhje u propozua ky rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Raportimi i Ministrit lidhur me rekomandimin e Komisionit, me dat. 21.09.2015**

I ftuar: Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë z. Arsim Bajrami.

Rektori i Univerzitetit të Prishtinës. z. Ramadan Zejnullahu.

- 1. Miratimi i rendit të ditës**

Kryesuesja – konstatoi se rendi i ditës u miratua, pa ndryshime.

2. Raportimi i Ministrit lidhur me rekomandimin e Komisionit, me dat. 21.09.2015

I ftuar: Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë z. Arsim Bajrami.

Rektori i Univerzitetit të Prishtinës. z. Ramadan Zejnullahu.

Kryesuesja, theksoi se është hera e tretë që nuk iu përgjigjet ftesës së Komisionit ministri i MASHT-it Arsim Bajrami dhe Rektori i UP-së Ramandan Zejnullahu. Konsideron se mospjesëmarrja e dy ahterëve kryesor dëshmon se është ikje e përgjegjësiëve për të raportuar lidhur me çështjen e regjistrimit të kandidatëve të komunitetit jo shumicë në Univerzitetin e Prishtinës. Institucionet e arsimit të lartë duhet t'ien përgjigjes ndaj kërkesave të komunitetit jo shumicë, nga se nuk është mirë të kufizohet e drejtat e shkollimit në vendin e tyre.

Kryesuesja- për diskutim fjalën ua dha anëtarëve të komisionit.

Veton Berisha, paraqet shqetësimin e tij lidhur me mospjesëmarrjen e ministrit dhe rektorit, pasi të njejt'jan ftuar disa her në takime të komisionit për të drejtat, interesat e komuniteteve dhe kthim ku neglizhenca e tyre dëshmon se nuk respektohen të drejtat e komunitetit jo shumicë.

Në fjalën e tij tha se po humbet kuptimi i diskutimit rreth kësaj çështje pasi ka filluar viti shkollor dhe çdo munges e studentëve në ligjerata reflekton negativisht për një fillim të mirëfillt shkollor. Ky fakt dëshmon se ka keqpërdorime nga se nuk sigurohet qasje e barabart për komunitetin jo shumicë, në nivel univerzitar. Komuniteti jon ka vullnet të mirë të jet pjesë e sistemit akademik e jo të mbetet jash shoqëris kosovare.

Nuk pajtohet me qëndrimin e Univerzitetit të Prishtinës, se të drejtë pranimi kanë kandidatët të cilët arrijnë kuotën e përcaktuar nga pikët e parapara në provim pranues, kur dihet se një numër i konsiderueshëm i kandidatëve të komunitetit pakic e kan arritur kuotën e kalueshmër, në nivel të parë, ndërsa të njejt' nuk janë pranuar.

Në kuadër të situatës së krijuar ai, kërkon që MASHT-i dhe UP-së të rishikoj edhe një her mundësin e shpalljes së koknursit plotësuses dhe nëse nuk arrihet konsus i përbashkët në mes dy palëve, propozoi që kjo çështje të ngritet në Qeveri për gjetjen e një zgjidhje të përhershme për studentët e komunitetit jo shumicë, të cilët kan vullnet të jenë pjesë e univerziteteve në Kosovë.

Danush Ademi, është i papranueshëm bojkoti i ministrit dhe rektorit nga se mbajn përgjegjësi të madhe që të respektohen përfaqësuesit e komunitetit jo shumicë. Kur bëhet fjal për studime të nivelit të lartë, viteve të fundit ndonëse numri i të regjistruarve është nën nivel dhe kjo çështje paraqet shkelje të rëndë të të drejtave të komunitetit jo shumicë.

Ajo çka e shqetëson më së shumti është fakti se Univerziteti i Prishtinës 'Hasan Prishtina' nuk do të përsëris konkursin ploësues për studentët e komunitetit jo shumic ndërsa do të shpall konkurs vetëm për studentët e luginës së Preshevës, Medvegjës, Bujanovcit, të Malit të Zi, Shqipërisë dhe Maqedonisë ndërsa. Mendon se veprimet e tilla dëmtojnë imazhin e shtetit të Kosovës dhe njëherit kërkoj që të njejtat të parandalohen dhe të mos përsëriten në të ardhmen.

Theksoi se një numër i konsiderueshëm i studentëve e kanë arritur kuotën e përcaktuar mirëpo shumica prej tyre kanë mbetur jashtë dyerve të fakulteteve. Kjo dëshmon se në programet ku janë garantuar 328 vendet të lira, janë pranuar vetëm 15 student të komunitetit të tij. Në këtë periudhë, rregullat e demokracisë tregojnë se ekzekutivi shumë pak ka investuar për promovimin e të drejtave të komuniteteve.

Nëse rektorati i UP-së nuk parasheh shpalljen e konkursit të tretë, atëherë e vetmja mundësia na mbetet të kërkojmë donacione nga ambasadat e huaja në Kosovë, që kjo kategori e studentëve të regjistrohen në fakultete private.

Ai kërkoi që Komisioni të bëjë trusni në rektoratin e Universitetit të Prishtinës, me mundësi të shpalljes së konkursit plotësues, për kandidatët e komunitetit jo shumicë.

Qerim Bajrami, mos pjesëmarrja e ministrit dhe rektorit lidhur me temën e shpalljes së konkursit plotësues paraqet mospërfillje të sistemit arsimor për komunitetin jo shumicë.

Theksoi se deri më sot MASHT-i dhe rektorati i UP-së nuk iu është përmabjtur premtimit të dhënë për shpalljen e konkursit të tretë, për vitin akademik 2015/16.

I drejtoi kritikën në adresë të Rektorit nga se janë bërë keqpërdorime lidhur me regjistrimin e studentëve të komunitetit jo shumicë, në nivel të parë. Ekzistojnë faktet që prej 328 vendeve të rezervuara, të regjistruar janë 30 student që i bie 10% nga numri i përgjithshëm, ndërsa kanë mbetur të pa regjistruar 50 student, në anën tjetër është dhënë mundësia të regjistrohen 8500 studentë shqiptar. Ai konsideron se publikimet e tilla janë të pa sakta të cilat dëmtojnë imazhin e komuniteteve, gjegjësisht të komunitetit boshnjak.

Me rastin e publikimit të rezultateve të testit në nivel të parë, konsideron se komuniteti që ai i përket, nuk duhet të jetë viktimë në mes MASHT-it dhe rektoratit të UP-së, por të mundësohet çësja e regjistrimit në universitetet e Kosovës. Pengesa kryesore është se testet nuk kanë qenë të shtypura në gjuhën turke dhe boshnjake, andaj është pamundësuar arritja e rezultateve të dëshiruara për provim pranues.

Duke pasur parasysh elementet e mësipërme, ai parashtroi dy kërkesa, e para është, që të bëhet trusni në Qeverinë e Republikës së Kosovës, ministrit z.Arsim Bajrami dhe rektorit z.Ramadan Zejnullahu, që të arrihet integrimi i komuniteteve në sistemin arsimor të Kosovës, me nevojë të veçantë të respektohen gjuhët zyrtare, Ligji për përdorimin e gjuhëve.

E dyta, kërkoi që MASHT-i dhe Rektorati i UP-së, në afat sa më të shkurtër të gjejnë mundësinë e shpalljes së konkursit të tretë, për regjistrim të kandidatëve të komunitetit jo shumicë, për vitin akademik 2015/16.

U ndërlidh me rëndësinë e çështjes së ngritur duke u deklaruar se nuk do të votojë projektligjin për buxhetin e vitit 2016, nëse Rektorati i UP-së nuk do të publikojë konkursin plotësues, për vitin akademik 2015/2016.

Agim Kikaj – kërkoi të bëhet kujdes dhe të mos politizohet kjo çështje por të identifiohen arsyet e autoritetit të rektoratit të UP-së apo të Senatit lidhur me procedurat e shpalljes së konkursit plotësues, për komunitetin jo shumicë. Ne do të kërkojmë të respektohen kriteret që testet të botohen në gjuhën amtare.

Falenderoi kryesuesen e komisionit për azhuritetin e saj me kërkesë për përgjegjet e marra me shkrim, nga ana e MASHT-ti dhe UP-së. Sot, para vetës i kemi shkresat të cilat do ti shtjellojm bashkarisht ku më pas komisioni do të dalim me rekomandime, që studentët me merita të konkurojnë në afatin e konkursit të tretë, të vitit akademik 2015/16.

Kryesuesja – në fund, konstatoi se pas përfundimit të takimit të ditës së sotme, do të dal në konferenc për media, me qëndrim konkret që ti rekomandon rektoratit të Univerzitetit të Prishtinës ‘Hasan Prishtina’ në Prishtinë, të ri-shpall konkursin plotësues për kandidatët e komunitetit jo shumicë, për vitin akademik 2015/16.

Mbledhja përfundoi në orën 14:15.

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetje të Komisionit

Kryetare e Komisionit

Jasmina Živković